



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE

27 gusht 2019

Nr. 61 Prot.

KOMENTE MBI PROJEKTLIGJIN**“PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”**

Duke vlerësuar pozitive çdo iniciativë ligjore që synon uljen e informalitetit në ekonomi dhe përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave, pasi u njohëm me projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me qëllim përmirësimin dhe hartimin e një legjislacioni sa më të zbatueshëm dhe efektiv, ju listojmë më poshtë disa komente dhe sugjerime:

1. Koha dhe mënyra e implementimit

Nga informacionet që ka Dhoma Amerikane, fatura elektronike në vendet europiane është bërë e detyrueshme fillimisht për marrëdhëniet e biznesit me qeveritë (në prokurimin publik (B2G) në bazë edhe të *Direktivës së Parlamentit Europian dhe Këshillit 2014/55/KE, datë 16 prill 2014, “Për Faturimin Elektronik në Prokurimin Publik”*.

Më pas, vendet kanë zgjedhur të aplikojnë, fillimisht në mënyrë vullnetare, faturat elektronike të cilat projektligji i referohet si pa para në dorë (B2B) dhe, si hap i fundit, faturat me para në dorë (B2C). Mendojmë se kjo është mënyra më e mirë për t’u implementuar edhe në Shqipëri. Nisur nga implementimi i sistemeve të tjera (sjellim si shembull dorëzimin e pasqyrave financiare në QKB), janë vënë re gjithnjë problematika të mëdha në fillimet e implementimit. Për këtë arsye, sugjerojmë që implementimi të realizohet me faza, duke filluar nga prokurimi publik, duke vazhduar me bizneset e mëdha dhe më pas me ato të mesme dhe të vogla. Ndryshe nga sa është parashikuar në projektligj, sugjerojmë që implementimi për shitjet me para në dorë të jetë hapi i fundit.

2. Kostot e implementimit

Nga projektligji dhe relacioni që e shoqëron atë nuk është e mundur të kuptohen apo përlogariten kostot që do të ketë biznesi për të përballuar kërkesat e këtij sistemi. Aktualisht, janë në përdorim pajisje fiskale për të cilat nuk është e qartë nëse janë apo jo të vlefshme për sistemin e ri. Të gjitha modelet e pajisjeve fiskale janë të certifikuara nga administrata tatimore, prandaj mendojmë se edhe në stadin aktual, është e mundur dhënia e informacionit për modelet të cilat mund të vazhdojnë të përdoren në sistemin e ri, si edhe për koston e përshtatjes së tyre me këtë sistem.

3. Rritja e numrit të deklarimeve dhe vështirësitë e përmbushjes në mungesë të një analize të qartë kosto-përfitim

Nga projektligji dhe relacioni kuptojmë që parashikohen të shtohen dhënia e një sërë informacionesh dhe deklaratash të reja, si për shembull: vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, përfshirë këtu edhe të dhëna të detajuara si orari i punës, ofruesi i internetit etj; regjistrimin e

operatorëve për lëshimin e faturave 24 orë përpara se të fillojë procesi, regjistrimin e prodhuesve dhe mirëmbajtjen e softuerëve, regjistrimin e blerjeve të mallrave në import, deklarimin e gjendjes së parave në fillim të ditës në arkë, etj.

Në gjykimin tonë, të gjithë këto elementë do të vështirësojnë mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri. Biznesit do t'i duhet të shtojë procedura të cilat nuk kanë qenë thelbësore në mbarëvajtjen e aktivitetit. Mbi të gjitha, nuk arrijmë të identifikojmë vlerën e shtuar që bërja e këtyre deklaramëve do të ketë në procesin e fiskalizimit.

Kështu, e gjykojmë të panevojshme deklarimin e posaçëm të operatorit të lëshimit të faturave. Së pari, duhet theksuar se përmbushja e detyrimeve tatimore është obligim i tatimpaguesit dhe jo i punonjësve (operatorëve) të tij. Ndërkohë që në relacion, deklarimi i operatorit është justifikuar me zbulimin e rasteve të mosdeklarimit të punonjësve, është e paqartë se si do të ndikojë kjo pasi tashmë ekziston detyrimi për t'i deklaruar të gjithë punonjësit 24 orë përpara fillimit të punës. Prandaj, deklarimi posaçërisht i shitësve apo faturistëve nuk do të sillte ndonjë ndryshim.

Në mënyrë të ngjashme, nuk identifikojmë asnjë dobi praktike në njoftimin e administratës tatimore për ndryshimin e ofruesit të internetit 24 orë përpara marrjes së shërbimit. Për nevojat e biznesit, ofruesi i internetit mund të ndryshohet disa herë në ditë, pa shkaktuar ndonjë pengesë në përmbushjen e detyrimeve tatimore. Në këtë rast, deklarimi i përcaktuar në projektligj për rastin në fjalë, jo vetëm që nuk lehtëson kushtet e të bërit biznes në Shqipëri por e gjykojmë edhe praktikisht jofunksional.

Për të gjitha më sipër, gjykojmë që do të kenë efekt të kundërt nga qëllimi i këtij ligji, duke lënë hapësirë për raste abuzimi me informalitetin dhe korrupsionin.

4. Rregullimi i pagesave me para në dorë

Dhoma nuk ka identifikuar ndonjë direktivë europiane apo praktikë të vendeve të zhvilluara që të kenë një rregullim të tillë.

Praktikisht, këto nene janë të pazbatueshme për arsye si më poshtë:

- ka një numër të konsiderueshëm njësisish administrative të cilat nuk kanë prezencë të asnjë dege të vetme bankare në territorin e tyre, çka praktikisht, e bën të pamundur aplikimin e këtyre neneve. Në shumë raste të tjera, fizikisht degët e bankave janë larg vendodhjes së biznesit duke e bërë të pamundur zbatimin praktik;
- në ligj nuk merren parasysh pagesat që bën me para në dorë biznesi, të cilat janë një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të biznesit;
- limitimet e vendosura do të krijojnë kosto të shtuara për bizneset (kosto në kohë fizike, kohë pritje, kosto transporti, kosto të shtuara bankare, risk i shtuar, veprime fiktive depozitimi dhe në të njëjtën kohë tërheqje krejtësisht të panevojshme etj.);
- sektorë të ndryshëm të ekonomisë kanë specifikat/karakteristikat e tyre dhe është e pamundur të përgjithësohen me 3-4 nivele limitesh.

5. Udhëzimet e Ministrit të Financave

Dhoma po ashtu vë re se shumë procedura dhe përjashtime janë lënë të përcaktohen me udhëzime të posaçme të Ministrit të Financave. Mendojmë se pa këto udhëzime është e pamundur të kuptohet se si do të zbatohen në praktikë disa nga nenet e ligjit. Për këtë arsye sugjerojmë që për konsultim publik të paraqiten njëkohësisht edhe projekt-udhëzimet.

6. Momenti i lëshimit të faturës

“Momenti i lëshimit të faturës në nenin 8 të projekt-ligjit përcakton mënyrat e lëshimit të faturës për shërbime dhe mallra në varësi të llojit të furnizimit dhe kategorive të subjekteve që e lëshojnë/marrin atë. Në pikën 5 të këtij neni përcaktohet dhe mënyra e lëshimit të faturës për disa mallra dhe shërbime të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt ose të vazhdueshme të realizuara midis një personi të tatueshëm dhe klientit të tij. Kjo pikë e cila prek kryesisht operatorët tregtarë që ofrojnë shërbime utilitare tek një bazë e gjerë klientësh (si shërbime telefonie, internet, uji, energji elektrike, etj.), parashikon se fatura tatimore në të tilla raste duhet lëshuar jo më vonë se dita e fundit e muajit përkatës për të gjitha furnizimet e kryera gjatë atij muaji.

Duam të sqarojmë se aktualisht furnizimi me të tilla shërbime me paspagesë (kontratë) realizohet në baza mujore dhe se procesi i përlogaritjeve të faturimit dhe i gjenerimit të faturës së detajuar dhe me TVSH për pajtimtarin/përdoruesin kërkon minimalisht 2-3 ditë kohë pas ditës së fundit të muajit që faturohet, për t’u realizuar.

Gjithashtu, procesi i shpërndarjes së faturës tatimore të printuar në adresën postare të konsumatorit zgjat deri në 15 ditë nga dita e fundit e muajit që faturohet, në varësi të vendodhjes së pajtimtarit.

Sugjerojmë që fatura të mund të lëshohet deri në 15 ditë pas kryerjes së shërbimit siç është dhe praktika e zakonshme në vendet e komunitetit europian.

7. Dokumentimi i pagesës me para në dorë të faturave të lëshuara

Pothuajse të gjitha shoqëritë e shërbimeve utilitare (furnizimi me shërbime telekomunikacioni, internet, ujësjellës etj) lëshojnë fatura në baza mujore. Pavarësisht përdorimit të institucioneve të ndërmjetësve financiarë, një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve paguajnë këto fatura me para në dorë pranë pikave të shitjes. Sjellim në vëmendjen tuaj se në shumë raste ka pika shitjeje që nuk kanë statusin e ndërmjetësit financiar por janë në rolin e ndërmjetësit për qëllime të furnizimeve me TVSH. Është e paqartë se cili do të jetë dokumenti që do të vërtetojë arkëtimin e pagesës me para në dorë të faturave që janë lëshuar dhe i janë vënë në dispozicion blerësve me anë të postës elektronike (pra si do të zëvendësohet transaksioni që aktualisht rregullohet nëpërmjet lëshimit të “*kuponi tatimor nga fatura e shitjes*”. Kjo e parë edhe në kuadër të rregullimit të pagesave dhe kufizimit të gjendjes së arkës.

Për këtë sugjerojmë që të rregullohet në mënyrë specifike dhe sidomos të marrë parasysh edhe periudhën tranzitore (fatura të lëshuara përpara fiskalizimit dhe të arkëtuara pas implementimit të sistemit).

8. Neni 18 "Pajisjet fiskale dhe zgjidhja softuerike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit"

Shumë tatimpagues, aktualisht kanë në përdorim softuerë për regjistrimin dhe kontabilizimin e çdo veprimi financiar që shoqëria kryen (duke përfshirë fatura shitje dhe blerje). Pajisjet elektronike të faturimit apo zgjidhja e certifikuar softuerike që do mundësojë lëshimin e faturës elektronike sipas parashikimeve të nenit 18, do të duhet të lidhet dhe integrohet me softuerin që biznesi ka në përdorim.

Referuar përmbajtjes së projektligjit, rezulton se përveç numrit të faturës dhe numrit serial që përmbajnë aktualisht faturat tatimore do të shtohen edhe numrat NIVF, NSLF dhe kodi QR. Sistemet softuerike që përdoren aktualisht nga bizneset kanë hapësirë të posaçme për regjistrimin e numrit të faturës dhe të numrit serial dhe nuk jep mundësinë për regjistrimin e numrave dhe/ose kodeve të tjera.

Në këto kushte, duke mos njohur zgjidhjen softuerike që do aplikohet për lëshimin e faturës elektronike, është e paqartë nëse do jetë e mundur lidhja dhe integrimi i këtij softueri me sistemet që bizneset kanë në përdorim pa implikuar kosto të konsiderueshme shtesë në ngarkim të subjekteve. Shumë prej ofruesve të shërbimeve për konsumatorët kanë sisteme të komplikuara të menaxhimit të klientëve (CRM) për të cilat modifikimi apo shtesa e moduleve kërkon kohë shumë më të gjatë sesa 2–3 muaj që parashikohet në projektligj.

9. Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe në librin e blerjes

Referuar rregullimeve të këtij projektligji, rezulton se në platformën qendrore në llogari të tatimpaguesit do të regjistrohen të gjitha faturat e shitjes dhe të blerjes të tatimpaguesit dhe sistemi informatik i administratës tatimore do të gjenerojë një libër shitje dhe një libër blerje. Librat e shitjes dhe të blerjes duhet të shqyrtohen nga tatimpaguesi deri në ditën e 10-të të muajit dhe ky i fundit ka të drejtë të bëjë ndryshime ose përditësime nëse është e nevojshme përpara se të konfirmojë saktësinë e tyre.

I gjithë sistemi i faturimit që propozohet nëpërmjet këtij projektligji dhe procesi i regjistrimit të faturave, paraqet paqartësi në lidhje me mënyrën se si subjektet do të pranojnë dhe miratojnë regjistrimin në librin e blerjes të faturës së shitjes që është lëshuar nga një subjekt tjetër tregtar.

Nga ana tjetër, ngarkesa e madhe e librave të shitjes ku do të regjistrohen të gjitha faturat e shitjes edhe në vlera shumë të ulta që do të lëshohen nga pikat e shitjes me pakicë, e cila sjell për rrjedhojë ngarkesë pune më të madhe për subjektet në momentin e shqyrtimit të librave.

Duke pasur parasysh, se me këtë sistem nuk do të ketë mundësi manipulimi apo lëshimi faturash pas ditës së fundit të muajit, data 10 mund të shtyhej të paktën deri në datën 20 të muajit pasardhës.

10. Pagesat me kartë krediti/debiti

Në projektligj është parashikuar se “Pagesa pa para në dorë” është pagesë për mallra ose shërbime që kryhen nëpërmjet bankës ose institucionit të parasë elektronike të licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe që për qëllim të këtij ligji, përfshin të gjitha mënyrat e tjera të pagesës të cilat nuk konsiderohen pagesa me para në dorë, sipas pikës “ë”, të këtij neni.” Kjo dispozitë do të krijojë konfuzion dhe trajtim disproporcional sidomos për sektorin gjithnjë e më në zhvillim të shitjeve në distancë. P.sh. një tatimpagues që përdor një kartë krediti ose debiti për të kryer një pagesë përmes një platforme *online* të ndërmjetësimit të pagesave mund të jetë një rast i cili nuk është i qartë a do të konsiderohet si pagesë “me para në dorë” apo “pa para në dorë”.